



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 122, Datë 24.05.2022

MBI

**MBI SHTYRJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S NË LIDHJE ME RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “KURUM INTERNATIONAL” SH.A., ME NR. 372 SERIA F12/17 NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 106, DATË 20.07.2012, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 13, pika 1 dhe 3, dhe nenit 14, pika 3, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.05.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 771/2 prot., datë 18.05.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “KURUM INTERNATIONAL” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 106, datë 20.07.2012, i ndryshuar”,

**Konstatoi se:**

- Në vijim të relatimit të Relacioni nr. 771/2 prot., datë 28.05.2022, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “KURUM INTERNATIONAL” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”, lindi nevoja për sqarime që lidhen me dokumentacionin financiar dhe atë teknik të aplikimit të shoqërisë dhe si e tillë vlerësohet shtyrja e afatit të vendimmarrjes së bordit të ERE-s me 20 (njëzet) ditë pune, për për t’iu drejtuar shoqërisë me shkresën respektive në lidhje me dhënien e sqarimeve për këto çështje.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të zgjasë me 20 (njëzetë) ditë pune nga marrja dijeni, afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s për rinovimin e licencës nr. 372 Seria F12/17, të shoqërisë “KURUM INTERNATIONAL” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 106, datë 20.07.2012.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.